



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr.^{82/1}..... Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 21/ 06 / 2023

VENDIM

Nr.20, date 21 /06/2023

PËR

**MIRATIMIN E MEMORANDUMIT TE MIREKUPTIMIT NDERMJET KOMITETIT
KOMBETAR TE DIGAVE TE MEDHA NE SHQIPERISE DHE
KOMITETIT KOMBETAR TE DIGAVE TE MEDHA TE JAPONISE**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytëzimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave", Neni 4, pika a,c,d, Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 21.06.2023 mori në shqyrtim Memorandumin e Mirekuptimit ndërmjet KKDM dhe JPCOLD të paraqitur nga Kryetari I KKDM, z. Arjan Jovani.

Nga shqyrtimi i Memorandumit të Mirekuptimit vërehet se përmes këtij dokumenti do të behet e mundur krijimi dhe rregullimi i kushteve institucionale të bashkëpunimit ndërmjet dy Institucioneve homologe në fushën e sigurisë së digave dhe do të përcaktohen prioritetet baze të këtij bashkëpunimi I bazuar në pavarësinë institucionale, respektin reciprok dhe parimeve universale të pranuar nga të dy palet. Të dy Komitetet do të krijojnë mundësinë e shkëmbimit të eksperiencave dhe njohurive në fushën e inxhinierisë së digave.

Pas diskutimeve të të gjithë antarëve të pranishëm, KKDM

VENDOSI:

Të miratojë Memorandumin e Mirekuptimit ndërmjet Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha të Shqipërisë dhe Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha të Japonisë sipas tekstit bashkëlidhur këtij Vendimi.

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për arkivimin e këtij Memorandumi si dhe ndjekjen dhe zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në këtë dokument , në përputhje me legjislacionin në fuqi. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI

Arjan JOVANI

